



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 127/2013
Prishtinë, më 16.12.2013, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti- kryetar, Teuta Sahatqija, zëvendëskryetare, Fikrim Damka, Sala Berisha–Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Visar Ymeri, Myzejene Selmani dhe Etem Arifi - anëtarë.

Munguan: Hashim Deshishku dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të tjerë: Arben Sylejmani, gazetar – BIRN/ Jeta në Kosovë.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.12.2013;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-232 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-240 për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikave të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.12.2013

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 10.12.2013, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-232 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës

Kryetari – Tha se Projektligji për Shërbimin Gjeologjik, ka qenë nismë e Komisionit për ta hartuar një projektligj që e rregullon këtë fushë. Pasi që është hartuar Projektligji nga ana grupit të punës, i udhëhequr nga deputetja Sala Berisha – Shala, është dërguar për në Qeveri, sipas proceduarve për mendim, ndërsa tani Qeveria e ka kthyer në Kuvend opinionin e saj, me të cilin pajtohet me këtë nismë. Theksoi se sipas Rregullores së Kuvendit, para leximit të parë në Kuvend, komisionet funksionale i shqyrtojnë në parim projektligjet dhe kërkoi nga deputetët që të paraqesin vërejtjet e tyre në parim. Propozoi që grupi i punës për Projektligjin për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, të jetë në përbërje, ashtu siç ka qenë në hartimin e draftit.

Sala Berisha-Shala – Tha se me këtë Ligj, po fillohet një epokë apo një fazë e re për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, sepse tani kjo fushë e ka një adresë dhe po rregullohet me ligj. Ajo shtoi se gjatë fazës së amendamentimit, duhet që të shërbehemi me përvojat e vendeve të tjera sesi e kanë të rregulluar shërbimin gjeologjik.

Pas debatit, Komisionit nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim, Projektligji nr. 04/L-232 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës.

Komisioni, Kuvendit ia paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet në parim, Projektligji nr. 04/L-232 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës.

Grupi i punës për shqyrtimin e këtij projektligji, ka këtë përbërje: Sala Berisha – Shala kryesuese, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Visar Ymeri dhe Etem Arifi- anëtarë.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-240 për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese

Kryetari – Po ashtu, sipas Rregullores së Kuvendit, para leximit të parë, duhet ta shqyrtojmë në parim këtë projektligj. Ai kërkoi nga deputetët që të paraqesin vërejtjet e tyre në parim dhe hapi debat.

Myzejene Selmani – Tha se Ligji për masat antidamping, është miratuar në mandatin e kaluar, mirëpo tani kemi një harmonizim më të gjerë me legjislacionin e BE-së. Duke marrë parasysh rëndësinë e tij, ne duhet ta shqyrtojmë këtë projektligj.

Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim, Projektligji nr.04/L-240 për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese.

Komisioni, Kuvendit ia paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet në parim, Projektligji nr.04/L-240 për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese.

Grupi i punës për shqyrtimin e këtij projektligji, ka këtë përbërje: Myzejene Selmani- kryesuese, Teuta Sahatqija, Lutfi Zharku, Shaip Muja dhe Fikrim Damka - anëtarë.

5. Të ndryshme

Çështjet vijuese

Myzejene Selmani - Kërkoj që ftohet në Komision, znj. Edita Tahiri, zëvendëskryeministre e Qeverisë, që të njoftojë Komisionin lidhur me Marrëveshjen për energjinë, që është nënshkruar në Bruksel me palën serbe.

Shaip Muja – Propozoi që, po ashtu, për këtë temë të ftohet edhe z. Fadil Ismaili, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, pasi që është kompetent për këtë fushë.

Teuta Sahatqija - Propozoi që të kërkohet një raport me shkrim, para se të vijnë për të raportuar përfaqësuesit e Qeverisë lidhur me Marrëveshjen për energji, që është nënshkruar në Bruksel me palën serbe, sepse duhet ta dimë dhe të kemi një njoftim bazë se për çka janë pajtuar të dy palët në bisedime.

Kryetari – I bëri thirrje deputetes Selmani se këtë çështje mund ta ngritë edhe në seancë dhe mund të marrë përgjigje drejtpërdrejt nga zëvendëskryeministrja, pa pasur nevojë që të diskutojmë ne si Komision.

Pas debatit, Komisioni vendosi që në mbledhjen radhës, të ftohen për raportim znj. Edita Tahiri, zëvendëskryeministre e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe z. Fadil Ismaili, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, lidhur me Marrëveshjen që është nënshkruar në Bruksel për energji, në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Zenun Pajaziti